



**DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E PRONËSISË INDUSTRIALE
(DPPI)**

Nr. 1537 Prot., datë 08.04.2025



BASHKIA KUKËS

Nr. 2063 Prot., datë 08.04.2025

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET:

**DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE
(DPPI)**

DHE

BASHKISË KUKËS

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi lidhet ndërmjet:

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE

e njohur më poshtë si **“DPPI”**

DPPI është institucioni i vetëm përgjegjës për regjistrimin, administrimin dhe promovimin e të drejtave të Pronësisë Industriale në Republikën e Shqipërisë, detyrim që i buron nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nga ligji organik nr. 9947, datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale” *i ndryshuar*, neni 189, si dhe nga dokumente strategjike si: Marrëveshja e Asociim-Stabilizimit në nenin 73 të saj, “Pronësia Intelektuale”.

DPPI funksionon në formën e një agjencie autonome, nën mbikëqyrjen e ministrit përgjegjës për ekonominë, pranë ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI).

Adresa e institucionit është: Bulevardi “Zhan D’Ark”, Ish - Shtëpia e Ushtarakëve, Prona Nr. 33, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga titullari:

Znj. Maria Solis – Drejtor i Përgjithshëm i Komanduar,

DHE

BASHKISË KUKËS

e njohur më poshtë si:

Njësi e Vetëqeverisjes Vendore (NJVV), person juridik publik, krijuar sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, që organizohet e funksionon sipas ligjit organik nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, *(i ndryshuar)* neni 28 .

Adresa e institucionit është: “Sheshi Skënderbej”, Lagjja nr. 5, 8501, Kukës, Shqipëri, përfaqësuar nga titullari:

Z. Albert Halilaj - Kryetar

Neni 1

Rëndësia e Bashkëpunimit

Duke patur parasysh se:

1. Pronësia Industriale është një shtyllë e rëndësishme për ngritjen dhe zhvillimin e një veprimtarie të qëndrueshme ekonomiko-sociale dhe kulturore të një vendi;
2. Ekziston një nevojë bashkëpunimi ndërinstitucional, me qëllim mbrojtjen e të drejtave të pronësisë industriale në vendin tonë;
3. Palët janë të interesuara të promovojnë dhe të përmbushin objektivat e përgjithshme për mbrojtjen e pronësisë industriale, që angazhohen në këto veprimtari;
4. Palët shprehin dakordësinë mbi rëndësinë e ndërgjegjësimit publik mbi pronësinë industriale dhe përçimin e saj në mbarë vendin.

Palët, bien dakord të nënshkruajnë këtë Marrëveshje Bashkëpunimi, sipas modaliteteve të mëposhtme:

Neni 2

Qëllimi i Bashkëpunimit

Fokusi i kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi, kryesisht do të jetë në përfshirjen në aktivitete të përbashkëta, panaire, me qëllim sensibilizimin e subjekteve tregtare në Bashkinë e qytetit të Kukësit.

Neni 3

Objektivat e Marrëveshjes

1. Organizimin e aktiviteteve të përbashkëta, me qëllim mbrojtjen dhe regjistrimin e objekteve të pronës industriale, për bizneset e qytetit të Kukësit;
2. Organizimit e tryezave të rumbullakta të përbashkëta dhe sesione bisedimesh, mbi mbrojtjen dhe regjistrimin e pronës industriale me fokus kryesisht identifikimin dhe promovimin e treguesve gjeografikë që ka zona e Kukësit.
3. Shkëmbimin e ndërsjelltë të informacionit mbi fushën e pronësisë industriale, nga Palët, kur ato e shohin të arsyeshme;
4. Çdo aktivitet tjetër me interes të përbashkët, në lidhje me fushën e pronësisë industriale.

Neni 4

Modalitetet e Bashkëpunimit

1. Secila Palë do të caktojë një koordinator të Marrëveshjes, përgjegjës për zbatimin e saj; konkretisht nga pala e DPPI-së, do të jetë: Drejtoria e Koordinimit, Promovimit dhe Trajnimeve, ndërsa për Bashkinë Kukës, do të jetë Drejtoria e Diasporës, Integritetit Evropian, Projekteve dhe Rinisë.
2. Ngritja e një grupi të përbashkët pune, për konkretizimin e bashkëpunimit me veprimtari të ndryshme;
3. Organizimin dhe vënien në dispozicion për publikun e gjerë, të informacionit dhe rezultateve të çdo veprimtarie të përbashkët;
4. Grupet e përbashkëta, do të përpunojnë mënyrat dhe veprimet e përbashkëta, për përmbushjen e qëllimit të kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi.

Neni 5

Afati i Marrëveshjes

5.1 Kjo marrëveshje, lidhet për një afat të pacaktuar. Përmbajtja e kësaj marrëveshjeje, mund të ndryshojë me pëlqimin me shkrim të të dyja palëve.

5.2 Kjo marrëveshje, mund të shfuqizohet me kërkesën e njëres palë, pas njoftimit paraprak me shkrim, të paktën 30 (tridhjetë) ditë përpara, që parashtrohet edhe arsytet e prishjes së kësaj marrëveshjeje.

Neni 6

Nënshkrimi dhe Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi nënshkruhet sot, më datë 08 / 04 /2025, në 2 (dy) kopje origjinale me vlerë të njëjtë, dy për secilën palë dhe hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga të dyja palët.

PALËT:

PËR:

**DREJTORINË E PËRGJITHSHME
TË PRONËSISË INDUSTRIALE
(DPP)
DREJTOR I PËRGJITHSHËM I KOMANDUAR
ZNJ. MARIA SOLIS**



PËR:

BASHKINË KUKËS

KRYETAR

Z. ALBERT HALILAJ

